



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Podujevë shpall:

---

## Konkurs

### Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

---

<b>Emri i grupit</b>	Specialist i Administrimit të Përgjithshëm
<b>Institucioni</b>	Komuna Podujevë
<b>Nr. i Referencës</b>	RN00010690
<b>Kodi</b>	RPC0004359
<b>Data e njoftimit</b>	29.12.2022
<b>Afati për aplikim</b>	19.01.2023 - 02.02.2023

---

## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

1. Organizimi dhe pjesëmarrja në punët e kontrollit të qarkullimit ilegal të masës drusore, kontrolli i tregjeve të shitjes së masës drusore, kontrollimi i pikave të përpunimit të drurit-sharrave, kontrollimi i prerjeve ilegale të pyllit, konfiskimi i masës drusore të prerë dhe transportuar ilegalisht;
2. Pas dakordimit me mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë dhe me Drejtorin, koordinimi i punëve me Policinë lidhur me kontrollën e qarkullimit ilegal të masës drusore;
3. Kontrollimi i rajoneve pyjore, mbrojtja e tyre nga prerjet ilegale, organizimi i punëve me rojet e pyjeve, revizionimi dhe kontrollimi i rajoneve pyjore, mbrojtja e tyre nga zjarret, sëmundjet, dëmtuesit, uzurpimet, fatkeqsitë elementare etj.
4. Përkujdesja që punët e kultivimit të realizohen në sasi, cilësi dhe afat kohor nga fituesit e ekzekutimit të punimeve në terren;
5. Angazhimi dhe pjesëmarrja në damkosje në pyjet e larta dhe të ulëta në të dy sektoret sipas kërkesës së inxhinierit;
6. Grumbullimi i të dhënave nga terreni për silvikulturë, shfrytëzim, mbrojtje, gjueti, peshkim, të cilat shërbejnë për hartimin e raporteve mujore dhe vjetore si dhe pjesëmarrja aktive sipas nevojës në hartimin e planeve vjetore dhe raporteve periodike javore, mujore dhe vjetore;
7. Dhënja e udhëzimeve dhe shpjegimeve rojeve të pyllit për dokumentacion përcjellës, udhëzimi i pronarëve privat lidhur me procedurat e lejitimit të prerjes në pronat e tyre;
8. Realizimi, kryerja e detyrave të tjera që i caktohen nga Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë dhe Drejtori i Drejtorisë.

## 2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

---

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

## 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

- Arsimitimi i kërkuar: Diplomë/a e shkollës së mesme apo ekuivalente me to.
- Kualifikime të posaçme formale: Nuk ka.
- Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohet.





## 9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

---

- Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme të kërkuara për Grupin përkatës.
- Vlerësimi i jetëshkrimit konsiston në vlerësimin e cilësisë dhe nivelit të arsimit, të përvojës domethënëse në punë dhe të trajnimeve që lidhen me vendin e punës në lëminë përkatëse të lidhur me Grupin përkatës.
- Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për Grupin përkatës që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim.

## 10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### Të dhëna shtesë:

Linku se si të aplikoni përmes platformës SIMBNJ:

<https://youtu.be/olwDDqCueZI>

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

